



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 2, 5 dhe 6 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034, e në zbatim të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 16.04.2014, Kuvendi Komunal i Gjilanit, në seancën e mbajtur me dt.24.04.2014 , merr këtë :

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-8367 të dt.09.07.2010 për ndalimin e shitjes së pronave publike nga AKP-ja.

1. Kuvendi Komunal i Gjilanit e shfuqizon Vendimin nr.01-8367 të dt.09.07.2010 mbi ndalimin e shitjes së pronave publike nga AKP-ja.
2. Kërkesat për pronat shoqërore të cilat janë të nevojshme për Komunën për realizimin e interesit publik , bëhen në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-144, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, dhe me dispozitat e Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës e dt.23/2013 .
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Nr.01. 16-46076
Gjilan, më 24.04.2014

Kryesuesja e Kuvendit,
/Valentina Bunjaku-Rexhepi/,